

AKT THEMELIMI

DHE

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“INTE-INFINITE TECHNOLOGY GROUP” SH.P.K



AKT THEMELIMI & STATUT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“INTE-INFINITE TECHNOLOGY GROUP” SH.P.K

Sot, më 05.02.2024 (dymijë e njëzetë e kater), personat si më poshtë;

- **Z. Gazmir Laçi**, i datëlindjes 05.10.1988, i biri i Beqirit , lindur në Guri i Bardh, Mate dhe banues në Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptare, me numër letërnjoftimi 037224670 nr personal I81005012O.
- **Z. Ergys Kaca**, i datëlindjes 02.08.1988, i biri i Tahirit , lindur në Vinjoll, Mate dhe banues në Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptar, me numër letërnjoftimi 035394774 nr personal I80802052J.
- **Z. Bledar Bardhi**, i datëlindjes 15.05.1983, I biri I Selimit, lindur në Peqin, Elbasan banues në Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptar, me numër letërnjoftimi 038148375 nr personal I30515070M, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 300,000 lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Z. Ervin Hoxha**, i datëlindjes 22.04.1981, i biri i Petritit, lindur në Durres, Shqiperi dhe banues në Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptar, me numër pashaporte BE7588760 dhe nr personal I10422081L.

Në mbështetje të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar dhe të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë kanë rënë dakort dhe vendosin të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe të hartojnë këtë Statut, mbështetur në parimet dhe kushtet e më poshtme:

Kreu I

Emri, Forma Juridike, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Emri

Shoqëria tregtare ka emërtimin “INTE-INFINITE TECHNOLOGY GROUP” SH.P.K

Neni 2

Të përgjithshme

Në këtë statut termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

Statuti: Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “INTE-INFINITE TECHNOLOGY GROUP” SH.P.K

ShoqëriaS:hoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “INTE-INFINITE TECHNOLOGY GROUP” SH.P.K

Ligji Tregtar: Ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”

QKB: Qendra Kombëtare e Biznesit

Shoqëria do të veproje në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe nenet e këtij statuti. Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur



dërgohen ortakëve në adresat fizike ose e-mail te deklaruara prej tyre pranë administratorit të shoqërisë.

Neni 3

Forma Juridike

Shoqëria ka statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre të nënshkruara për kapitalin.

Neni 4

Objekti

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- Në fushën e import-export të materialeve të ndërtimit, dyer të blinduara dhe të brendshme, dyer anti zjarr , dyer hotelerie
- Në fushën e Instalimit, riparimit dhe mirmbajtjes së dyerve të blinduara, të brendshme dhe të jashtme.
- Në fushën e import-export të materialeve për arredim dhe mobilim për hotele, njësi shërbimi komplekse dhe apartamente.
- Në fushën e ndërmjetesimit për shitblerjen dhe qiradhenien e pasurive të patundeshme.
- Në fushën e ndertimeve, rikonstruksioneve, mirembajtjen e godinave, banesave dhe ambjenteve të ndryshme banimi, komerciale dhe industriale private dhe publike.
- Në fushën e administrimit, pastrimit dhe mirembajtjen e objekteve dhe godinave të ndryshme banimie komerciale.
- Në shërbimeve të marketingut mediatic; çdo formë vizuale, të printuar, dixhitale si edhe përmes internetit.
- Në fushën e shërbimeve për krijimin dhe menaxhimin e reklamave dixhitale të bizneseve të ndryshme ose produkteve të tyre.
- Në fushën e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së platformave digjitale, webiste dhe app.
- Në organizimin e panairëve, eventeve të ndryshme si edhe aktiviteteve festive dhe promovuese brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë
- Në fushën e konsulencës në marketing dhe zhvillim biznesi.
- Në çdo fushë dhe aktivitet tjetër tregtar që lejon ligji dhe përfshihet në veprimtaritë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, sh.p.k.

Shoqëria mund të zgjerojë dhe/ose të pakësojë rast pas rasti objektin e veprimtarisë së vet me vendim të organeve të saj kompetente.

Neni 5

Selia

Shoqëria e ka selinë e saj në: Rr. Ali Demi, Kompleksi Green Key , shkalla 2 ,Kati 4 , ap 28, Tiranë.

Ajo mund të celë dhe adresa aktiviteti të tjera të dyta, degë e filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 6

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

Kreu II **Kapitali**

Neni 7

Kapitali themeltar total i nënshkruar i shoqërisë është 1.000.000 (Njemilion) lekë dhe ndahet në 4 kuota. Pjesëmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- **Z. Gazmir Laçi**, i datëlindjes 05.10.1988, lindur në Guri i Bardh, Mate banues në Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptar, me numër letërnjoftimi 037224670 nr personal I81005012O., zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 300,000 lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Z. Ergys Kaca**, i datëlindjes 02.08.1988, lindur në Vinjoll, Mate banues në Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptar, me numër letërnjoftimi 035394774 nr personal I80802052J, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 300,000 lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Z. Bledar Bardhi**, i datëlindjes 15.05.1983, lindur në Peqin, Elbasan banues në Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptar, me numër letërnjoftimi 038148375 nr personal I30515070M, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 300,000 lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Z. Ervin Hoxha**, i datëlindjes 22.04.1981, lindur në Durrës, Shqiperi banues në Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptar, me numër pashaporte BE7588760 dhe nr personal I10422081L, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 lekë që përbën 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar do të shlyhet me afat deri në një vit. Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 8

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogelohet sipas vendimit të ortakëve.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kërkohet për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Në rastin e largimit apo përjashtimit të ortakut nga shoqëria sipas parashikimeve ligjore, kuota e tij anulohet pa miratimin e ortakut përkatës, duke u shoqëruar në mënyrë të njëkohshme me zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë. Në një rast të tillë anulimi i kuotës ndodh vetëm pasi largimi apo përjashtimi i ortakut ka përfunduar plotësisht në saj të vullnetit të palëve apo një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Neni 9

Ortaku mund të transferojë të tretëve kuotat e tij të kapitalit pjesërisht ose tërësisht. Transferimi i kuotave tek të tretët do të bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim asambleja e ortakëve me shumicë absolute të votave.

Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:



- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes
- c) trashëgimisë
- d) dhurimit
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj

Kreu III

Organët vendimmarrëse dhe drejtuese të shoqërisë

Neni 10

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- (i) Asambleja e Përgjithshme e ortakeve;
- (ii) Administratori/ ët;

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

Asambleja e ortakeve

Neni 11

Asambleja e ortakeve është organi më i lartë vendimor i shoqërisë.

Asambleja e ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë, sa herë e shih të arsyeshme si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare". Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithëshme thirret të paktën një herë në vit e domosdoshmërisht për të miratuar pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Neni 12

Kompetencat

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shpërndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;



- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 13

Thirrja dhe pjesëmarrja në asamble

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me postë elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, mënyrën e mbledhjes kur është e ndryshme nga mbledhja fizike, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe ju dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht kesaj parregullsie.

Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje personalisht ose të përfaqësuar sipas parashikimeve ligjore.

Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje fizikisht ose jo fizikisht nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet elektronike, që mundësojnë identifikimin e tyre, të tilla por pa u kufizuar si:

- a) transmetimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në kohë reale, si video konferencë, etj;
- b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nga një vendndodhje tjetër, si konferencë telefonike, etj;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje, si projekt vendim qarkullues në formë elektronike, postare apo dorazi, ku secili prej ortakëve jep miratimin e tij me shkresë duke nënshkruar vendimin përkatës (vendim qarkullues), etj.

Për efekt të këtij neni, konsiderohen mjete dhe burime të sigurta identifikimi për të kryer njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme si dhe për të garantuar pjesëmarrjen jo fizike të ortakëve në mbledhje:

- (i) adresat postare, elektronike dhe numrat e telefonit të dorëzuara në formë shkresore (përfshirë e-mail, sms, aplikacione) nga ortakët tek Administratori/ët i shoqërisë, ortakët të tjerë të shoqërisë, ose punonjës të autorizuar të shoqërisë; dhe/ose
- (ii) adresat postare, elektronike dhe numrat e telefonike të përdorura nga ortakët, me të cilat ato kanë mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me Administratorin/ët, ortakët e tjerë, apo anëtarë/punonjës të tjerë të shoqërisë dhe që njihen gjërësisht sa i përkasin atij; dhe/ose
- (iii) sitemet teknologjike të lidhjes audio dhe video që disponon shoqëria.

Neni 14

Kuorumi dhe vendimmarrja

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ose mjete elektronike sipas parashikimeve të këtij Statuti.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të

përmendur më sipër, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend ditor.

b) Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë dhe për raste të tjera që sipas këtij Statuti kërkohet shumicë e cilësuar. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 10 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

c) Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përmban datën, orën e vendin dhe/ose mënyren e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Procesverbalit i bashkangjitet dhe lista e pjesëmarrësve dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/ët është/janë përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve.

d) Mbledhja e Asamblesë kryesohet nga një prej anëtarëve të saj të caktuar rast pas rasti nga Asambleja.

Neni 15

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat (¾) e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për:

- a) ndryshimin e statutit,
- b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
- c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore
- ç) shpërndarjen e fitimeve,
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- dh) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Organi Administrativ

Neni 16

Asambleja e përgjithshme emëron një ose me shumë persona fizike si administrator të shoqërisë. Afati i emerimit është deri në 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit të tyre në QKB.



Neni 17

Kompetencat

Administratori/ët kanë të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 4 të këtij statuti.

Organi Administrativ (administratori) ka të drejtë dhe duhet të:

- a) kryeje me mirëbesim të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakëve e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajnë pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryeje detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f) marrë dhe shkarkojë nga puna personelin dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me të gjithë punonjësit.
- g) përfaqësojë apo emërojë përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria ose në çështje të tjera me palë të treta;

Administratori/ët është kompetent edhe për të:

- (i) realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- (ii) propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë, hapjen, përcaktimin, zhvillimin e departamenteve të shoqërisë dhe të vendeve të tjera të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë;
- (iii) propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme në interes të shoqërisë.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë, përveç rasteve kur në vendimin e emërimit shprehet ndryshe.

Neni 18

Administrator i parë i shoqërisë "INTE - INFINITE TECHNOLOGY GROUP" emërohet Z. Gazmir Laçi, i datëlindjes 05.10.1988, lindur në Matë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, Shqipëri, shtetas Shqipëtar, me numër letërnjoftimi 037224670 dhe nr personal I810050120. Afati i mandatit të administratorit të parë do të jetë 5 (pesë) vjet nga data e miratimit të këtij statuti.

Kreu IV

Kushtet ekonomike

Neni 19

Shoqëria është pronare, disponuese dhe përdoruese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si çdo person tjetër juridik në Shqipëri; mund të blejë, të shesë, të japë në përdorim, etj.



Neni 20

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përbashimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 21

Në fund të çdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve në fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nënshkruhen nga administratori i shoqërisë. Pasqyrat financiare vjetore nënshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Neni 22

Pas miratimit të bilancit vjetor dhe shpërndarjes së të ardhurave dhe mbajtjes së rezervës ligjore, Asambleja përcakton shumën që do të ndahet si dividend, në përpjestim me kuotën që zotëron çdo ortak.

Neni 23

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut do zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Mosmarrëveshjet e punonjësve me shoqërinë do të zgjidhen në gjykatën shqiptare.

Kreu V

Dizpozita të veçanta

Prishja – riorganizimi i shoqërisë

Neni 24

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë, për shkaqet:

- a) me vendim të Asamblesë së Ortakëve për prishjen e shoqërisë;
- b) sipas rasteve të parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) me vendim të gjykatës;

Neni 25

Në rastin e prishjes së shoqërisë, Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet ndaj punonjësve, shtetit e më pas ndaj të tretëve. Në rastin e tepicës së kapitalit të shoqërisë me përfundimin e likuidimit, kjo i shpërndahet Ortakëve.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.



Neni 26

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Asamblesë së përgjithshme të Ortakëve , në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Baza ligjore

Neni 28

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjetër në Republikën e Shqipërisë.

Neni 29

Shoqëria ka vulën e vet në të cilën shkruhet emri i shoqërisë siç e parashikon ligji.

Neni 30

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt palët i drejtohen Gjykatës së Republikës së Shqipërisë për zgjidhje.

Neni 31

Ky statut u përpiluar në tre kopje me fuqi të barabarta secila, për t’u depozituar në QKB, për t’u shpërndarë në organët kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë, pasi e lexuan këtë Statut, deklarojnë se e kanë kuptuar përmbajtjen e saj dhe janë dakort me kushtet e saj, prandaj e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë si më poshtë vijon, si shprehje e qëllimit dhe miratimit të tyre.

Tirane me 05.02.2024

ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË
“INTE - INFINITE TECHNOLOGY GROUP ”SHPK

Gazmir Laçi

Ergys Kaca

Bledar Bardhi

Ervin Hoxha

Gazmir Laçi

ERGYS KACA

Bledar Bardhi

Ervin Hoxha